



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:219355

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830188

C.nr.2380/22.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË–Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: R. M. etj, të gjithë nga Peja, të cilët i përfaqëson Muhamet Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, baza juridike: *Pagesë e tri pagave të papaguara dhe shujtat ditore*, vlera e kontestit: 9980.92€, jashtë seance, me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: R. M. etj, ashtu që:

II.DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që në emër pagave të fundvitit për vitet 2018,2019, 2020 dhe 2021, të ju paguajë paditësve shumat si në vijim dhe atë:

1.)Paditësit të parë R.M., shumën prej 2648.24€.

2.)Paditëses të dytë Z.B., shumën prej 2452.00€.

3.)Paditësit të tretë E.B., shumën prej 2452.00€.

4.)Paditësit të katërt V.K., shumën prej 2428.68€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë (dt.24.10.2022), e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III.REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, me të cilën kanë kërkuar që të „DETYROHET e paditura që në emër të kompensimit për shujta ditore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, dhe atë 1.)Paditësit të parë R.M., për 923 ditë të kaluara në punë. 2.)Paditëses të dytë Z.B., për 869 ditë të kaluara në punë. 3.)Paditësit të tretë E.B., për 890 ditë të kaluara në punë. 4). Paditësit të katërt V.K., 926 ditë të kaluara në punë, t’iu paguajë paditësve, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.”

IV. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën prej 320€, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 24.10.2022, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, duke kërkuar që të Detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që në emër të tri pagave të fund vitit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t’iu paguajë për secilin vit, si dhe shujtave ditore për

vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, me kamat ligjore prej 8% në vitë duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, si dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë. Gjendjen faktike e ka përshkruar si në vijim:

Paditësi R.M., është i punësuar me orar të plotë në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht në Policinë e Kosovës që nga data 23.09.2002 e tutje. Paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës dhe për punën e tij merr pagën mujore prej 662.06 euro. Me datën 14.11.2018 Policia e Kosovës ka nxjerr udhëzimin Administrativ me nr.02/2018, me anë të cilit policëve që kanë përfomancë të mirë të obligohet të u paguaj pagën e trembëdhjetë që është ekuivalente me pagën mujore që i bie 662.06 euro dhe shujtat ditore për ditët që kanë punuar që nga nxjerrja e këtij udhëzimi e deri më sot, por Policia e Kosovës këto paga dhe as shujtat ditore nuk i ka paguar asnjëherë paditësit edhe pse paditësi ka treguar performancën e kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ. Paditësi gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në Policinë e Kosovës ka punuar 923 ditë.

Paditësja Z.B., është i punësuar me orar të plotë në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht në Policinë e Kosovës që nga data 19.06.2000 e tutje. Paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës dhe për punën e tij merr pagën mujore prej 613.05 euro. Me datën 14.11.2018 Policia e Kosovës ka nxjerr udhëzimin Administrativ me nr.02/2018, me anë të cilit policëve që kanë përfomancë të mirë të obligohet të u paguaj pagën e trembëdhjetë që është ekuivalente me pagën mujore që i bie 613.05 euro dhe shujtat ditore për ditët që kanë punuar që nga nxjerrja e këtij udhëzimi e deri më sot, por Policia e Kosovës këto paga dhe as shujtat ditore nuk i ka paguar asnjëherë paditësit edhe pse paditësi ka treguar performancën e kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ. Paditësja gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në Policinë e Kosovës ka punuar 869 ditë.

Paditësi E.B., është i punësuar me orar të plotë në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht në Policinë e Kosovës që nga data 23.09.2002 e tutje. Paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës dhe për punën e tij merr pagën mujore prej 613.15 euro. Me datën 14.11.2018 Policia e Kosovës ka nxjerr udhëzimin Administrativ me nr.02/2018, me anë të cilit policëve që kanë përfomancë të mirë të obligohet të u paguaj pagën e trembëdhjetë që është ekuivalente me pagën mujore që i bie 613.15 euro dhe shujtat ditore për ditët që kanë punuar që nga nxjerrja e këtij udhëzimi e deri më sot, por Policia e Kosovës këto paga dhe as shujtat ditore nuk i ka paguar asnjëherë paditësit edhe pse paditësi ka treguar performancën e kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ. Paditësi gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në Policinë e Kosovës ka punuar 890 ditë.

Paditësi V.K. është i punësuar me orar të plotë në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht në Policinë e Kosovës që nga data 16.01.2006 e deri më sot. Paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës dhe për punën e tij merr pagën mujore prej 607.17 euro. Me datën 14.11.2018 Policia e Kosovës ka nxjerr udhëzimin Administrativ me nr.02/2018, me anë të cilit policëve që kanë përfomancë të mirë të obligohet të u paguaj pagën e trembëdhjetë që është ekuivalente me pagën mujore që i bie 607.17 euro dhe shujtat ditore për ditët që kanë punuar që nga nxjerrja e këtij udhëzimi e deri më sot, por Policia e Kosovës këto paga dhe as shujtat ditore nuk i ka paguar asnjëherë paditësit edhe pse paditësi ka treguar performancën e kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ. Paditësi gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në Policinë e Kosovës ka punuar 926 ditë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses të saj, pranë kësaj gjykate ka paraqitur përgjigje në padi, duke theksuar se: Nuk është kontestuar fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e

paditura duke u mbështetur në vërtetimin e punësimit. Mbështetur në dispozitën e nenit 78 par.1 të Ligjit nr.03/L-212 i Punës përcaktohet se i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura, par.2 „Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda prej 15 ditëve, nga data e pranimit të kërkesës. Mbështetur në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet se ‘„Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2, të këtij ligji, afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicoj kontest pune në Gjykatën Kompetente”. Në bazë të kësaj paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme të ankimit.

Kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, e kanë kundërshtuar pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policës së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht neni 20.par.4, për Buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policës së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe nenin 29 pik 2 të UA.nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore-financiare, nuk ka mundur të realizohet pagesa e 13-të. Për kompensimin e pagës 13-të, kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh detyrimin, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës, e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të shpërblehej për pagën e 13-të dhe shujta, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *„Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmyet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *„Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit ta kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjatë vlerësimit dhe analizimit të pretendimeve të paraqitura nga palët ndërgjyqëse me padi, përgjigje në padi dhe provat, gjykata ka vërtetuar faktin, se paditësi R.M., është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës, që nga dt.23.09.2002, dhe gëzon pagë mujore prej 662.06€, për një muaj kalendarik,

-paditësja Z.B., është e punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës, që nga data 19.06.2000, dhe gëzon pagë mujore prej 613.05€, për një muaj kalendarik,

-paditësi E.B., është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 23.09.2002 dhe gëzon pagë mujore prej 613.15 euro për një muaj kalendarik,

-paditësi V. K. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 16.01.2006 dhe gëzon pagë mujore prej 607.17€, për një muaj kalendarik, fakte të vërtetuara nga *„Vërtetimi i punësimit”* e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, ndërsa fakti mbi vlerësimin e performancës, është vërtetuar me formularët e vlerësimit të performancës për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, me të cilët paditësit janë vlerësuar secili mbi nivelin e kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuar edhe nga pala e paditura.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se „Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, gjykata i ka marr të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror, respektivisht nga vetë e paditura.

Gjykata përfundimisht nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, vërtetojë se themelësia e kërkesëpadisë, bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, që përcakton se „I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se „Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 se „Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që në nenin 5.par.2 përcakton se „Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se „Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit.”, një të drejtë e parasheh edhe neni 30 i Udhëzimit Administrativ me nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si të punësuar pranë saj t’ia paguajë një pagë shtesë, ekuivalente me pagën mujore, për çdo fund vit, pasi janë plotësuar edhe kushtet për një të drejtë të tillë, siç parashihet në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2019, 2020 dhe 2021, ka qenë i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata ka pasur parasysh faktin se me Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, i cili ka hyrë në fuqi me datën 29.09.2021, është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, i cili ka hyrë në fuqi me dt.14.11.2018, mirëpo sipas kësaj gjykate, personeli i policës kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri me datën 29.09.2021, dhe ka qenë i karakterit të detyrueshëm, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikoj mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshme çdo arsyetim eventual, për mungesë të mjeteve buxhetore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se paditësve, nuk ju takon kompensimi i shujtave ditore, duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 1 të UA 02/18, që përcakton se „Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, e në lidhje me nenin 47, paragrafi 4 të Ligjit për Policinë që përcakton se „Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për shujta ditore duhet të jetë shprehimisht i përcaktuar që të mund të vije në shprehje zbatimi i kësaj

dispozite, ndërsa në rastin konkret meqë nuk ekziston ky përcaktim në legjislacionin në fuqi, e as në aktet nënligjore, kjo dispozitë mbetet e karakterit deklarativ, por nuk mund të ketë fuqi detyruese për palët nënshkruese.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, se të njëjtit nuk kanë mjete financiare, për pagesën e kërkuar nga paditësi, për gjykatën një pretendim i tillë është jo relevant, pasi që drejtat e kërkuara nga pala paditëse janë të parashikuara në Udhëzimin Administrativ, dhe të njëjtat duhet t'i përmbushin obligimet që kanë ndaj punëtorëve.

Gjykata, për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012, ku shprehimisht është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore bazuar nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën e përgjithshme prej 260€ edhe atë: prej 104.00€, për përpilimin e padisë, taksës gjyqësore për padi në shumën prej 60€.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 398 të LPK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.2380, me dt.18.06.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.